

RECEPTIMI I VEPRËS SË BILAL XHAFERRIT NË HISTORIOGRAFINË LETRARE SHQIPE XHAFERRI RECEPTION OF THE LITERARY WORK IN ALBANIAN LITERARY HISTORIOGRAPHY

IRMA BILALI

Gjumnazi gjuhësor "Shejnaze Juka", Shkodër, SHQIPËRI
email: irmasokoli@yahoo.it; siisokoli@gmail.com

AKTET VI, 3: 335 - 323, 2013

PERMBLEDHJE

Artikulli përqendrohet në konfigurimin e disa karakteristikave kryesore të këndvështrimit të per-so--nalletit krijues të Bilal Xhaferit në historiografinë letrare shqipe. Sipas studiuesve vepra letrare e këtij autori shpërfaq tipare krejt origjinale në letërsinë shqiptare të viteve '60. Ecuria e studimit ësh--të parë nën projektimin e disa prej linjave teorike të gjykuara si të përshtashme për të shpjeguar rrjedhën e mendimit kritik shqiptar ndaj veprës së Xhaferit në letërsinë shqiptare, në për-gjithësi dhe dallimin e shfaqjeve individuale. Pas viteve '90 ka pasur çdo herë e më shumë një qa--sje më moderne të interpretimit të letërsisë, duke përfshirë në këtë përpjekje edhe studimin për ve--prat letrare të autorëve disidentë. Niveli i leximit të veprës së Xhaferit dhe i kritikës let--ra--re ndaj saj është më se i pranueshëm, por është e domosdoshme të përcaktohet në mënyrë shke--n--co--re vendi i kësaj vepre në historiografinë letrare shqiptare. Gjykoj se përpjekjet e studiuesve du--hen thelluar akoma më tej për një paraqitje sa më dinjitoze të vlerave dhe individualitetit krijues të tij.

Fjalë kyce: historiografi, kritikë, individualitet, receptim, dissidence.

SUMMARY

The treatment focuses on the configuration of some key characteristics of the viewpoint towards one of literary individualities with particular importance to the historiography of the Albanian literature. According to researchers, in this literary work, the author reveals original features of the Albanian literature in the '60s. Performance of the study is seen in the design of some of the theoretical lines deemed appropriate to explain the flow of Albanian critical thinking for the works of B. Xhaferri in the Albanian literature, in general, and to distinguish individual perfo--r--ma--nces. After 90s there was always more and more of the modern interpretation of the literature, also including the studyings about the literary works of dissident writers. the reading level the works of B. Xhaferri and the literary criticism against it is more than acceptable, but the place of the works of Xhaferri must be determined scientifically and objectively in the historiography of the Albanian literature. I think that the efforts of researchers have to be deepened even further for a more dignified presentation of these authors' values and individuality denied for a long time.

Key word: historiography, critics, individuality, reception, dissence

Hyrje

Historiografia si shkencë ka të bëjë me shkrimin e historisë, nëse asaj do t'i shtojmë përcaktorin letrare vetvetiu do t'i drejtohem kritereve, rrethanave dhe mënyrave të dokumentimit të krijimtarisë letrare të një populli. Ndarja e

historisë së letërsisë sipas shekujve është një ndarje komode (Pazzaglia 2005: 6). Që nga hershmëria ndarja kronologjike i ka paraprirë kritereve të emërtimit të periudhave e shkollave letrare.

Autori që kemi marrë si objekt studimi i takon shek. XX. Në historinë e letërsisë shqiptare, krijimtaria letrare e shekullit XX nuk mund të merret si një e tërë dhe në përcaktimet e shumta e gjejmë të ndarë si letërsia e gjysmës së parë dhe ajo e gjysmës së dytë, që është pasojë e një dikotomie të theksuar në mes të këtij shekulli me problematika të shumta për gjithë historinë e kombit. Sot në 100 vjet shtet shqiptar, besoj se duhet të vëzhgojmë në mënyrë kritike, dokumentat, kulturën, politikën, religjionet të cilat përbëjnë identitetin tonë, të cilat na tregojnë se kush jemi, se kush duhet të jemi e se çfarë mund të bëhemi. Historia e letërsisë shqipe ka tiparet e saj të afrueshme me letërsinë e tjera të zhvilluara në vendet e tjera europiane po aq sa ka dhe veçoritë e saj individuale

1. Pjesa teorike

Procesi letrar shqiptar mbarëkombëtar, në rrjedhë të viteve njihet luhatje dhe kronologji të ndërprera dhunshëm e dhimbshëm për arsye jashtëletrare. Shkenca letrare dhe letërsia jonë për të kuptuar të tashmen është e nevojshme të kthejë kokën pas, të analizojë udhën e saj që në hershmëri e deri në bashkëkohësi. Në mënyrë të tillë do të kërkojmë rrugën nëpër të cilat ka ecur shkrimi dhe receptimi i veprave letrare të shkruara nga autorët që lanë gjurmë në letërsinë tonë. Kjo sigurisht është më e pakta që mund të arrihet për të kuptuar dhe cilësuar vlerat e kombit, për të gjetur çelësin e veprimit dhe të kundërveprimit drejt asaj që është më emergjente, shkrimin e plotë, objektiv e të paanshëm të historisë së letërsisë shqipe, konceptuar dhe shtruar si detyrë kjo dhe nga autoritet e kësaj shkence në Shqipëri. I referohem në këtë rast autores F. Dado kur pohon se: *historia e letërsisë mbart funksionin themelor të rindërtimit të letërsisë në proceset e gjata të zhvillimit historik, duke zbuluar përmes hetimit të formave artistike, evolucionin shpirtëror dhe krijues të një populli* (Dado 2009: 16).

Studimet historiko-letrare i kushtojnë rëndësi veçantë tipareve të veprës, rolit që ajo luan bashkë me veprat e tjera të rrjedhës letrare për

të vënë baza mbi dukuritë e zhvillimit letrar, në bazë të një objektiviteti shkencor që lejon të vihen në dukje vlerat ideore e artistike. Sipas Jaussit mënyra më e sigurt për të përcaktuar rolin që luan vepra e një shkrimtari në kohën kur shfaqet në procesin letrar, marrëdhënien që ajo krijon me publikun e kohës, është shqyrtimi i dokumenteve që lidhen me veprën në fjalë (Jauss sipas Smaqi 2009: 192).

2. Pak biografi

Bilal Xhaferri, punëtor në kantierin e Ulzës – u shpall fitues në konkurse letrare. U botuan edhe poezitë e para në gazetën "Drita" dhe "Rinia". Kështu shumë shpejt në radhët letrare hyri një emër i ri, një talent i vërtetë, siç shpreheshin dashamirësit, shkruan Ballkiz Halili nga përvoja e njohjes dhe hulumtimi në shtypin e kohës, në parathënien romanit Krastakraus, romanit që u kthye në karton para se të shihte dritën e botimit. Shkrimtar poliedrik dhe i frytshëm, një përhapës i madh i letërsisë shqipe dhe i trashëgimisë klasike në vendin e tij dhe në diasporë, B. Xhaferri zë një vend të spikatur në historinë e letërsisë shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX. Vepra e tij duhet të pozicionohet sipas kriterëve shkencorë historiografike letrare.

3. Vendi i B. Xhaferrit në mendimin e studiuesve shqiptarë

Bilal Xhaferri paraqitet si një shkrimtar unik, shembull i jashtëzakonshëm i shkrimtarit të palodhur, edhe pse pengesat dhe vështirësitë janë pjesë e pandarë e rrugës së tij. "Poeti i nëmun" e quan me të drejtë Sabri Hamiti në studimin e tij (Hamiti 1996: 345). Pavarësisht vëmendjes dashakeqe dhe injorimit të kësaj figure në kursin e viteve deri në '90 Xhaferri afirmohet me prepotencë dhe siguri në lëmin e letërsisë shqipe si një nga shkrimtarët e viteve '60 që sollën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj letërsie. Në këto vite lindin vepra që synojnë të thellojnë një letërsi që heton me një vizion kritik qoftë të tashmen, qoftë të kaluarën nëpërmjet një divulgimi të romanit historik duke përfshirë në rrëfim ngjarje dhe personazhe të epokave të caktuara. Në mënyrë

specifike vihet re evokimi i periudhës së Skënderbeut siç është vënë re edhe nga studiuesit tanë. Kur risjellim në vëmendje vepra të tilla, i drejtohem i titujve “*Krastakraus*” të autorit në fjalë, “*Kështjella*”, të Kadaresë, “*Skënderbeu*” i Sabri Godos. Afërsia kronologjike ka bërë që të zhvillohet edhe një tematikë e përbashkët, por gjithsesi e dallueshme për nga tipologjia e shkrimit, intriga e stili i rrëfimitarisë. Ky këndvështrim bën të mundur që të studiohen në plan krahasues vepra të tilla.

Vetë vepra e tij poezia, tregimi, romani janë të lidhura me rrënjët e etnisë dhe ngjarjet historike të vendit. “Balada çame”, përsëri sipas Hamitit (Hamiti 1996: 352), është dhimbja vetjake e njëjtësuar me dhimbjen për atdheun e copëtuar dhe shpërguljen e detyruar. Dhimbja e tij nuk thërret vetëm për çamët e jugut, vargu poetik shtrihet deri në tragjizmin qindravjeçar të Kosovës në poezinë “Kosova”.

Sfondi historik e shoqëron artin krijues si një shtysë e brendshme si një formë revolte ndaj fatit të padrejtë ilirianëve e pasardhësve të tyre. E ndoshta këtu do të zinin vend me të drejtë përshtypjet e Bajronit pas vizitës në Shqipëri: *Nuk ka komb që të jetë parë me aq urrejtje dhe tmerr prej fqinjëve sa shqiptarët. Grekët nuk i marrin me rëndësi për të krishterë, as turqit për myslimanë dhe e vërteta është se ata janë një përzierje e të dyjave dhe herë-herë as njëra as tjetra* (Bajron :7).

Armiqësia ndaj këtij populli të vogël shkaktoi plagët e pambyllura akoma dhe vuajtja e dhembja historike e shqiptarëve bëhet motivi bazë i veprës B. Xhaferrit. Zërat vajtues të tragjedisë që vijnë nga fëmijëria e hershme jehojnë në vargjet e rrëfimit të tij. I brengosur, por i ndriçuar ai kërkon nëpërmjet imagjinatës një urë kalimi ndërmjet reales dhe sureales e strehuar në brishtësinë e poetit.

Në opusin e tij letrar rrëfimi me karakter historik përforcohet sidomos në romanin *Krastakraus*, rishpikja e së kaluarës mbështetet në nostalgjinë ndaj historisë e ndoshta me një keqardhje prekëse ndaj së kaluarës, e shprehur nëpërmjet një alegorie melankolike dhe dramatike të së

tashmes drejt përjetësisë, një fundosje të shpresave iluzive në kujtimet e harruara.

4. Receptimi i veprës së Xhaferrit në kohën e krijimit

Me interes vërehet edhe mënyra se si erdhi dhe si u prit në letërsinë shqipe Xhaferrit në një kohë kur skematizmi kishte mbuluar një pjesë të madhe të veprave që botoheshin në atë periudhë. Siç është vënë re dukje nga shkrimet mbi autorin, Xhaferrit ofron një kuadro gjithëpërfshirëse në lidhje me shoqërinë letrare të kohës së tij duke sjellë në të njëjtën kohë dëshmi të një moderniteti dhe origjinaliteti individual. Pozicionimet e mendimit shqiptar vihen re dukshëm “*Nuk jam gabuar aspak kur në mendjen time prej adoleshenti e përcatova si një Ivo Andriç thellësisht të shqiptarizuar, me veçoritë dhe ekstraktin e ushqyer nga toka mëmë. E ndjeva si detyrë morale që jo vetëm ta lexoj e rilexoj disa herë me laps në dorë romanin “Krastakraus”, por me aq sa më lejojnë njohuritë e mia, të shpreh disa nga veçoritë që e bëjnë tepër të dallueshëm këtë roman të zhanrit historik*” (Muça 2011).

Problemet e komunikimit me lexuesin dhe censurimi për një kohë të gjatë, ka bërë që edhe receptimi i veprës të jetë i ndryshëm si pasojë e ndryshimeve, horizontit të pritjes në kohë dhe periudha të ndryshme historike e sociologjike. Një nga bashkëkohësit e tij disidentë që përshkoi ferrin e burgut komunist, Visar Zhiti dëshmon “*Ndërsa këtu komplottohej me heshtje ose kujtohej vetëm për t’u sharë (ose për t’u rrvrarë), të burgosurit politikë në Spaç, Qafë – Bari, Burrel, nëpërmjet atyre që e kishin njohur, kujtonin dhe mësonin përmendësh vargje të Bilal Xhaferrit* (Zhiti 2007).

Kërkojmë të vëmë në dukje këtu se komunikimi mes artit dhe receptuesit të tij ka kanale komunikimi krejt të veçantë. Në thelb ky komunikim ka të qenit bashkë pavarësisht hapësirave.

Prerja diakronike dhe vështrimi sinkronik janë ndërthurur vazhdimisht në studimin e shkrimtarisë së Xhaferrit. Kritika ka ndjekur veprën e tij, sidomos pas viteve ‘90 kur është

risjellë në atdhe fjala e autorit me anë të botimeve të librave, krijimit të një shtëpie botuese me emrin e tij, organizimit të konferencave e simpoziumeve shkencore. Në vitin 2010, 15 vite pas vdekjes tragjike të shkrimtarit disident *Ministria e Kulturës dhe Katedra e Letërsisë në Universitetin e Tiranës, studiuesi Bashkim Kuçuku, sollën jo më trupin apo eshtrat e Bilal Xhaferit, por një pasuri kulturore të varrosur, duke pasuruar edhe kulturën dhe liraturën shqiptare*" (Shahaj: 2010).

Pas ndryshimeve historike për Shqipërinë në '90, në librat mësimorë që u botuan fillon të shfaqet emri i autorit. Citoj nga letërsia bashkëkohore shqiptare e vitit 2001: *Në vitet '60, me përmbledhjen e parë me tregime "Njerëz të rinj, tokë e lashtë", Bilal Xhaferri, solli një lirizëm të ngrohtë dhe tepër human në letërsinë shqiptare. Ai rishfaqti personazhin e punëtorit me virtytet dhe dobësitë njerëzore, duke iu kundërvënë punëtorit të trajtuar bardhe zi në letërsinë skematike. Ndërsa vëllimi i tij Lirishita e kuqe u hoq nga qarkullimi. Impakti që ai krijoi tek bashkëkohësit krijon siluetën e një artisti elitari i cili guxon të ngrihet mbi tabutë e të thotë mendimin e tij të hapur rreth atyre që ishin rrethuar me aureolën e shkrimtarit. Mjaftoi një kritikë dashmirëse që Bilali i bëri romanit "Dasma" të Ismail Kadaresë, në një nga diskutimet e organizuara nga LSHA dhe inkuizitorët e kuq e gjetën pretekstin për ta shpallur atë si heretik dhe veprën e tij herezi. Më vonë në librin Ftesë në Studio vetë Kadare do të pohojë se romani Dasma ka qenë një nga shkrimet e tij më të dobëta.*

Lidhur me arratisjen e tij si pasojë e censurës, sulmeve të njëpasnjëshme miku i tij Namik Mane dëshmon: *"Poema "Mjergulla" është shkruar në gusht të vitit 1969, disa ditë para se Bilali të arratiset nga Shqipëria. Kjo poemë mbyllte vëllimin e përbashkët poetik "Një siluetë në errësirë", që Bilali dhe unë e krijuam gjatë viteve të internimit. Në këtë vëllim mbizotërojnë motivet e fatit tragjik të popullsisë çame. Mbas shumëurvejimeve, vendosa ta gropos këtë vëllim. Kur e nxorra nga dheu, pak vargje mund të lexoheshin* (Mane Namik 2007: 3).

Arratisja e tij, siç dëshmohej, ndodhi në atë kohë kur vëllimi me poezi u bllokua pa rënë në dorë të lexuesit dhe me urdhër nga lart u kthye në karton, kur romani i tij i parë "Krastakraus", megjithëse u cilësua si një perlë në letërsinë shqiptare s'kishte më asnjë shpresë botimi. (Halili, Ballkiz: 7).

Duke vënë theksin tek anatemat shqiptare, Sabri Hamiti sjell në vëmendje faktin që vepra e Bilal Xhaferit anatemohej për shkak të shkrimtarit, ashtu si ajo e Konicës, Kutelit, Koliqit e të tjerëve më radhë (Hamiti 2010: 319). Në mbështetje të kësaj teze vjen edhe opinioni i Dritëro Agollit në një intervistë drejtuar atij ku pyetet për lidhjet e Xhaferit me letërsinë dhe përjashtimin e tij nga Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë. *Në këtë periudhë të letërsisë kishte disa shkrimtarë si lloji i Bilal Xhaferit dhe disa të tjerë, të cilët regjimi nuk kishte dëshirë të dilnin në publik dhe të botonin libra ku të shprehnin opinionet e tyre. Kjo nuk ishte punë thjesht letërsie, pasi duke u ndaluar aktivitetin krijues ata arrinin t'i pezullonin në të gjitha drejtimet* (Agolli 2007).

Agolli po kështu vazhdon me vlerësimin e figurës së autorit në fjalë duke patur parasysh edhe mendimin e bashkëkohësve të tij. Një ndër admiruesit e Bilalit ishte dhe Vath Koreshi, atëherë redaktor i gazetës "Zëri i rinisë", i cili e vlerësonte lartë krijimtarinë e tij dhe e ndihmonte për t'i botuar poezitë, publicistikën dhe tregimet. Në përgjithësi të dy librat u pëlqyen shumë (Agolli 2007).

Në kuadrin e receptimit të krijimit letrar cilësia e vëmendjes së lexuesit influencon mënyrën e të kuptuarit të tekstit dhe domethënies së tij. Duke u nisur nga kjo mund të themi bindshëm se Xhaferri e ka fituar publikun modern falë veprës së tij origjinale dhe të hapur ndaj çdo dimensionit qoftë ai kohor, mjedisor e social.

Xhaferri ka kultivuar një prozë me tipare moderne e postmoderne, që bazohen në vizionin historiko-fantastik, ligjërimin alegoriko-poetik, dhe monologun e brendshëm të rrjedhës së vetëdijes. Jeta dhe vdekja që thërrasin njëra-tjetrën në kërkim të qenies njerëzore. Në një nga antologjitë e letërsisë bashkëkohore shqiptare për shkollat e mesme e vitit 1998, B. Xhaferri

vlerësohet për një sensibilitet të lartë artistik, një gjuhë artistike plot figura dhe një muzikalitet mbresëlënës.

Përfundime

Të analizosh sot atë që ka ndodhur dekada më parë përballë së sotmes në historinë e letërsisë shqipe mund të të sjellë spuntun për të thelluar arsyet e problematikave dhe pasaktësive të mundshme. Në këtë parashtrim kemi synuar të risjellim në vëmendje këndvështrimet e ndryshme mbi veprën së B. Xhaferrit nga studuesit e letrave shqipe që nga dalja në dritë e tyre e deri në ditët tona. Me të drejtë ky autor konsiderohet si një zë i çmuar në enciklopedinë letrare shqipe. Ai është shembulli i shkrimtarit që u përndoq për arsye të biografisë personale kur vepra e tij sillte risi të dukshme në letërsinë shqipe në vitet '60.

Hetohet në këtë hulli për të arsyetuar mbi shtysën demokratike dhe inovative që përmbajnë këto vepra dhe të cilat duhet të vijnë tek brezat e rinj për t'i shtyrë ata drejt një formimi të plotë letrar. Mendojmë se duhet orientuar kahu studimor në mënyrë që të mos përfundojë në shkrimet dëshpëruese të njëanshme, por të reflektojë mbi motivet dhe mënyrën e të shkruarit dhe të gjykuarit të letërsisë.

Në çdo rast një fakt duket i qartë dhe i pakundërshtueshëm, do t'ia dalim të superojmë këto sprova të reja për të shkruar mbi baza të vërteta teoriko-shkencore historinë e letërsisë shqipe vetëm nëse do dimë të lidhim fijen e së kaluarës me tezat e reja shkencore, duke përforcuar kështu më me forcë dhe bindje thirrjet më të hershme të kulturës sonë. Xhaferrit është akoma një burim i pashtershëm studimesh dhe shtytjesh për hulumtime të mëtejshme.

Bibliografia

- AGOLLI, Dritëro (2007), Dritëroi në një dritë të re: *Krahu i Shqiponjës*, 3, 12, Tiranë.
- ALIU, Ali; SINANI, Shaban; ÇAPALIKU, Stefan; ÇOBANI, Tonin (2001), *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Alb-Ass, Tiranë.
- DADO, Floresha (2009), *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë.
- DERVISHI, Kastriot (2009), *Masakra në Çamëri*, Dëshmitë e të mbijetuarve mbledhje dokumentash arkivore, përgatiti, ShB 55, Tiranë.
- HALILI, Ballkiz (1993), *Kratakraus*, Shtëpia botuese "Bilal Xhaferrit", Tiranë.
- HAMITI, Sabri (1996), *Poeti i nëmun Bilal Xhaferrit*, Vepra letrare 8. Prishtinë.
- HAMITI, Sabri (2010), *Poetika shqipe*, 55, Tiranë. <http://www.forumishqiptar.com/> (8/12/01 6:14:53 pm);
- MANE, Namik (2007), *Krahu i Shqiponjës*, 11,12, Tiranë.
- MUÇA, Vladimir (2011), Intensiteti i vlerave dhe thellësia retrospective me dukuri të reja të romanit historik (rreth romanit "Kratakraus" të Bilal Xhaferrit: *Obelisk*, nr 137, Tiranë. <http://www.botimetada.com/krijimtari/studime.html>
- Gusht 2011**
- PAZZAGLIA, Mario (2005), *Il novecento*, Terza Edizione, Zanichelli, Bologna.
- SMAQI, Laura (2009), *Zbulim i vetvetes në pasqyrë të letrave*. (Proza e shkurtër e Ernest Koliqit), Maluka, Tiranë.
- SHAHAJ, F (2010), Bilal Xhaferrit, botohet vepra e plotë e shkrimtarit dissident: *Koha Jonë*, 27 nëntor, Tiranë.
- ZHEJI, Gjergj, XHAFKA, Natasha (1998), *Maja e çelur*. Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare, ShBlSh, Tiranë. .